



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Korab Lita – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Elton Haxhi- Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë
Elvis Koçi- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave
Agron Muslia- Drejtor i Analizës së Përputhshmërisë në Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Artur Kala- Drejtor i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Kjo është mbledhja e dytë që zhvillojmë sot. Në pjesën e dytë të mbledhjes kemi në rend dite tri çështje: shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; shqyrtimin e projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Në të tria projektligjet komisioni ynë do të jetë komision përgjegjës. Të tria projektligjet janë paketë dhe reflektojnë disa ndryshime që kanë të bëjnë me rekomandimet e Moneyval-it, por jo vetëm. Kolegu Alket Hyseni është relatori dhe dua t’i sugjeroj, meqenëse kanë ardhur të tria projektligjet në paketë, që të bëjë një raportim për të tria projektligjet. Ftoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave që të bëjnë një raportim në parim për të tria projektligjet në paketë, sepse sot kemi vetëm shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtyre projektligjeve, pasi ka edhe dy komisione të tjera për dhënie mendimi dhe janë në fazën e shqyrtimit dhe të miratimit nën për nën. Në pritje të ardhjes së raporteve nga komisionet e tjera, sot ne do të miratojmë vetëm në parim këtë paketë.

Nga Ministria e Financave të ftuar kemi: zotin Elton Haxhi, zëvendësministër, zotin Elvis Koci, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, dhe zotin Artur Kala, Drejtor i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Zoti Haxhi, zoti Kala, mirë se keni ardhur në komision.

Zoti Haxhi, ju lutem, bëni shkurtimisht prezantimin e paketës që keni sjellë në Komisionin e Ligjeve.

Elton Haxhi – Faleminderit, kryetar!

Më lejoni të bëj një paraqitje të përgjithshme të të gjithë historikut afatshkurtër që nga fillimi i procesit të rishikimit të vendit tonë nga Komiteti MONEYVAL, dhe të bëj një pasqyrë të qartë se ku ndodhemi dhe çfarë jemi duke bërë.

Të nderuar anëtarë të komisionit, në muajin korrik të vitit të kaluar komiteti Moneyval i Këshillit të Europës ka miratuar raportin e raundit të V të vlerësimit të kuadrit institucional ligjor dhe atij rregullator në vendin tonë, në drejtim të zbatimit të 40 rekomandimeve

ndërkombëtare të grupit të posaçëm të veprimit financiar FATF në fushën e parandalimit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë periudhës 2016-2018 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është angazhuar në mënyrë intensive në udhëheqjen dhe koordinimin e këtij procesi të vlerësimit të vendit, i cili në tërësinë e tij ka qenë kompleks dhe kërkonte përfshirjen dhe koordinimin e një sërë institucionesh publike, por edhe angazhimin serioz të sektorit privat. Nga ky raport rezultojnë si të përmbushura plotësisht 28 rekomandime, ku 10 prej tyre janë të përmbushura pjesërisht dhe 1 është i papërmbushur. Krahësuar me raundin e IV, me raundin paraardhës të vlerësimit të vitit 2010, rezultojnë 30 rekomandime të përmbushura pjesërisht dhe 3 të papërmbushura. Duket qartë se ka një përmirësim të ndjeshëm në aspektin teknik të rekomandimeve.

Për sa i përket efektivitetit, sepse vlerësimi ka edhe pjesën teknike, edhe efektivitetin, rezultati është në përputhje me mesataren e vendeve të vlerësuara nga Moneyval, nga 11 rezultate imediate, siç quhen nga Moneyval, 2 janë të vlerësuara me efektivitet substancial, 7 me efektivitet të moderuar dhe 2 me efektivitet të ulët. Në këtë kontekst vlen të theksohet vlerësimi me efektivitet substancial i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe vlerësimi i efektivitetit të masave parandaluese të ndërmarra nga subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sepse bëhet fjalë për sistemin bankar.

Sidoqoftë në këtë drejtim ka disa sfida në fusha të rëndësishme, të cilat duhet të adresohen nga një gamë e gjerë autoritetesh që trajtohen në mënyrë të detajuar në vijim. Për adresim sa më të shpejt dhe efektiv të të gjitha rekomandimeve të raportit të sipërpërmendur u ngrit Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave i kryesuar nga Kryeministri, i cili në datën 4 shtator të vitit 2018 ka miratuar një plan të detajuar veprimi për pjesën e përputhshmërisë me kriteret teknike, si dhe pjesën e efektivitetit. Në zbatim të këtij plani Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka kryesuar punën për hartimin e projektligjeve, që ju keni në tavolinë, konkretisht: “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”. Përveç këtyre, paketa e ndryshimeve ligjore, që ne kemi përgatitur apo jemi duke e përgatitur, përfshin edhe ndryshimet në vijim. Kemi bërë disa ndërhyrje të tjera ligjore në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe disa ndryshime në ligjin për procedurat tatimore, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, synojnë forcimin e detyrimit për deklarimin e të

dhënave të pronarëve përfitues në regjistrin tregtar, si dhe detyrimin specifik të personave juridikë për të pasur llogari bankare nëpërmjet së cilës kanalizohen të gjitha transaksionet tregtare. Jemi kujdesur që te detyrimi për të pasur llogari bankare kemi përjashtuar bizneset, të cilat nuk janë subjekt i TVSH-së. Pra, biznesi i vogël që nuk është subjekt i TVSH-së, nëse nuk është person juridik, por është person fizik, nuk do të ketë detyrim për të pasur llogari bankare. Kjo është bërë për të ulur kostot për këtë fashë të biznesit, ndërsa e gjithë pjesa tjetër, personat juridikë, pavarësisht nga xhiroja, si edhe personat fizikë, të cilët janë subjekte të TVSH-së, do të kenë detyrim që të kenë llogari bankare dhe të gjitha transaksionet tregtare të kalojnë nga llogaria bankare. Kjo bëhet për të forcuar të gjithë kuadrin e monitorimit në aspektin e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave, por edhe si një masë direkte kundër informalitetit.

Një tjetër ndryshim ligjor, është shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i cili synon unifikimin e administrimit të procesit penal me atë antimafia. Deri sot ligji aktual i ngarkon agjencisë administrimin e procesit lidhur me ligjin antimafia, ku nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore synojmë që ta shtrijmë fushën e veprimit për ta pasur në një agjenci të vetme edhe administrimin e pasurive nga proceset penale.

Nën drejtimin e Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme është hartuar një projektligj i ri për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, i cili synon implementimin e sanksioneve kundër financimit të armëve të shkatërrimit në masë.

Gjithashtu, Ministria e Financave ka nisur punën për krijimin e dy regjistrave të rëndësishëm në fushën e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave, që janë: regjistri i pronarëve përfitues dhe regjistri i llogarive bankare, të cilët janë në përmbushje të dy direktivave të Bashkimit European, përkatësisht direktivat 4 dhe 5 dhe për këtë qëllim është siguruar edhe një asistencë nga Bashkimi European dhe Këshilli i Europës.

Përveç këtyre janë edhe një sërë masash të tjera, që unë nuk po hyj në detaje, pasi do të kemi raste të tjera për t’i diskutuar, por nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit sa më të shpejtë të projektligjeve të paketës Moneyval ne synojmë që të sigurojmë një përputhshmëri në rritje me pjesën teknike dhe atë efektive të sistemit parandalues në vendin tonë.

Përmbushja brenda një kohe sa më të shpejtë e të gjitha mangësive të evidentuara nga rekomandimet të Moneyval është e një rëndësie të veçantë dhe kërkon angazhim ndërinstitutional, në mënyrë që të sigurojmë një përputhshmëri në rritje me aspektin teknik dhe atë të efektivitetit të rekomandimeve. Kjo do të sigurojë edhe shmangien e procedurave të monitorimit të thelluar nga ana e FATF-së, gjë që do të kishte efekte të ndjeshme për vendin tonë. Në fund të muajit qershor ne duhet të raportojmë për zbatimin e rekomandimeve në

komitetin e Moneyval dhe gjatë 6-mujorit të dytë të viti 2019 pritet që MONEYVAL të bëjë një *follow up* të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Në fund të vitit 2019 presim një vlerësim të këtyre zbatimeve, që do të ndikoni pozitivisht, nëse do të ishte pozitiv, në aspektin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nëse ka pyetje apo çështje të tjera që lidhen specifikisht me tri ligjet që kemi në shqyrtim, jemi të hapur për t'iu përgjigjur bashkë me kolegët që më shoqërojnë.

Ju falënderoj!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhi!

Zoti Hyseni, ju lutem një relativim për të tria projektligjet!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe kryesinë e komisionit që më dha mundësinë të jem relator i kësaj pakete të përbërë nga tri ligje. Kjo edhe për faktin se puna që prezantohet sot është nisur në kohën kur unë kam qenë drejtor i Përgjithshëm i Pastrimit të Parave, është vazhduar nga administrata së bashku me Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Konfiskuara!

Falënderoj ish-ministrin e Financave dhe ministren aktuale për sensibilitetin që kanë treguar për këtë paketë, e cila nuk është thjesht një paketë e nevojshme, por e domosdoshme për të përmirësuar legjislacionin shqiptar, edhe për shkak të pasqyrimin që bëri zëvendësministri lidhur me detyrimet që Republika e Shqipërisë ka për shkak të aderimit të saj në disa organizma të rëndësishëm ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit apo ngrirjes dhe administrimit të aseteve që burojnë nga veprimtaria kriminale.

Sfidat globale bëjnë që shteti të jetë më i përgatitur, në kuptimin e një legjislacioni më konkret, më të qartë dhe me procedura strikte për t'iu përgjigjur kriminalitetit në rritje në rang global. Nga ana tjetër, organizimi strukturor i agjencive ligjzbatuese në rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave apo Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara, bën që të mos mbetemi thjesht në kuadrin e programimit të disa ligjeve të bukura, por të jemi në një fazë të avancuar, sikurse e përsëriti zëvendësministri. Pra, tashmë jemi në fazën e monitorimit, ku nuk na kërkohet thjesht fjalë, por na kërkohen rezultate dhe eficiencë. Rezultatet dhe efienca vijnë vetëm duke përmirësuar paketën ligjore, e cila në këtë rast vjen në zbatim të rekomandimeve FATF-së, të *Moneyval-it*, por transponon pjesërisht edhe rekomandimet e direktivave të BE-së, sidomos të direktivës së vitit 2015. Edhe pse në fokus, kjo paketë nuk ka në vetvete përfarimin total me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Më lejoni t'ju sqaroj se vetë direktivat e Bashkimit Europian kanë qenë dinamike vitet e fundit. Është bërë në vitin 2015, por ka pasur një direktivë të re në maj të vitit 2018 dhe jam i bindur që përsëri do të kemi një pasurim të kësaj direktive, gjë që do të na bëjë që në vijim të

kemi një transpozim të plotë të kësaj direktive, por është domosdoshmëri që ta kalojmë menjëherë këtë paketë, e cila ka mjaft risi në vetvete, jo gjëra të shpifura, por të mira, të marra nga partnerët ndërkombëtarë, nga legjislacionet e vendeve Perëndimore, tek të cilat përherë kemi gjetur atë bahçen pjellore ligjore për të marrë ligjet më të mira.

Për këtë paketë jemi konsultuar me grupe të ndryshme interesi, me shoqatën e bankave, me institucione të tjera shtetërore, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila ka një rol të rëndësishme në konsultimet për këtë paketë, por edhe në zbatimin e kësaj pakete apo edhe për aktorë të tjerë, me noterë, me grupe të tjera interesi, të cilat janë ose subjekte të zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit ose subjekte përfituese indirekte të të mirave të këtij ligji.

Nuk dua të zgjatem në arsyet e qenësishme të kësaj pakete, por ajo që është e rëndësishme është fakti se, sado që kemi pasur në vijimësi përmirësim të legjislacionit, ka pasur kryesisht mangësi procedurale, të cilat kanë sjellë, rast pas rasti, që reagimi i institucioneve të mos jetë në kohën e duhur, duke lënë shtigje apo hapësira. Fatmirësisht, nuk ka pasur pasoja në Shqipëri, por teorikisht kanë qenë të hapura për t'i dhënë mundësi krimit të organizuar për të vepruar.

Çfarë është sjellë me këtë ligj?! Sikurse u përmend, janë 3 ligje, ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, që është ligji i parë bazë, ligji “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe ligji “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Ligjet, si paketë, kanë synuar të bëjnë efikasë mekanizmat shtetërorë. Tashmë aksioni i madh shtetëror të jetë i numërueshëm dhe i kontrollueshëm që, kur të vijë raportimi i radhës në *Moneyval*, të kemi rezultate konkrete, jo thjesht që po ndiqet, por për t'i thënë se mekanizmat ligjorë tashmë janë më të mirët e mundshëm dhe mund të krenohemi, sepse janë më të avancuarit e vendeve të Bashkimit Europian, por edhe më gjerë, sepse *Moneyval*-i përfshin një gamë më të gjerë vendesh se vetë Bashkimi Europian.

Nëpërmjet ristrukturimit të Agjencisë së Administrimit, që është ligji i tretë, detajimit të mënyrës së funksionimit të kësaj agjencie, kompetencave të reja që merr kjo agjenci, bëjmë të mundur që pasuritë e administruara nga veprimtaritë kriminale të mos katandisen në kocka dhe në fund buxheti i shtetit apo shoqëria nuk arrin të përfitojë asgjë nga këto lloj veprimtari kriminale, të cilat treten dhe, kur vjen një ditë, nuk mund të rikuperohen. Kjo nuk sjell asgjë të mirë për shoqërinë, sepse, në fund të fundit, duhet analizohet edhe konfiskimi, i cili proceduralisht është i gjatë pas përfundimit të proceseve gjyqësore, gjë që shpeshherë ka bërë që të dëmtohet dhe të humbë vlera e pasurive shtetërore.

Po ashtu, i është dhënë mundësi Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, që është një nga institucionet (dhe unë gjej rastin këtu dhe ftoj kolegët që

ta dinë këtë fakt) që punon si sahat, ku ka njerëz të devotshëm dhe të përkushtuar, por i është dhënë mundësi mekanizmave të rinj që të veprojnë menjëherë në kohë, qoftë në kuadrin e përgjithshëm të pastrimit të parave, por qoftë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po të ftoj që ta dish. Duhet të jesh krenar që është agjenci shtetërore, sepse është jona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ministria ka rolin e saj, por kjo është një agjenci specifike. Këto janë agjenci, të cilat kanë një varësi që shpesh vjen drejtpërdrejt nga Kryeministri dhe, sikurse e përmendi, është Komiteti Kombëtar për Luftën kundër Pastrimit të Parave që jep orientimet bazë dhe është mbledhur për herë të parë mbas shumë vjetësh, qoftë në vitin 2017, qoftë në vitin 2018 dhe kanë qenë pikërisht rezultatet e atij komiteti që kanë sjellë këtë paketë.

Zoti Fino, presion ka pasur gjithmonë nga të gjitha institucionet partnere, por vetëm vitet e fundit po duken veprimet konkrete.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në veprimtarinë e saj ka pasur problematika të afateve të veprimit. Me këtë paketë jemi përpjekur. Kjo paketë nga sot dhe deri ditën që do të diskutohet nen për nen mund të përmirësohet. Janë të ftuar të gjithë deputetët ta bëjnë këtë. Edhe dje kemi qenë duke punuar; do të kemi konsulta në vijim për ta bërë paketën më të mirë të mundshme. Unë kam thënë se nuk ka asnjë ligj perfekt, ka vetëm qëllim perfekt. Kur qëllimi është perfekt, edhe ligji mund të bëhet i tillë, në mënyrë që rezultati në fund të jetë perfekt. T'i japim Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave mundësinë që të transpozojë akte ndërkombëtare menjëherë në kohë, sepse ka ndodhur që vendimmarrje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për listimin e subjekteve apo personave si terroriste kanë kaluar në procedura, të cilat shpesh kanë vonuar. Fatmirësisht Shqipëria nuk ka pasur pasojë, por, tashmë, me këtë paketë ligjore mundësia e tyre dhe e të gjitha institucioneve shtetërore është që të veprojnë menjëherë, sapo vihen në dijeni për këto vendimmarrje të rëndësishme, pa pritur që të kryhen procedura të zgjata të legjislacionit të brendshëm. Kemi risi, se tashmë nuk janë vetëm institucionet shtetërore, por të gjitha subjektet e këtij ligji, madje edhe persona të zakonshëm, që, nëse vihen në dijeni të vendimmarrjeve të rëndësishme dhe kanë kontakt apo marrëdhënie me elementë të tillë, duhet të pezullojnë çdo veprimtari dhe e kanë detyrim ligjor tashmë jo thjesht çështje dëshire apo të drejte.

Jemi munduar të unifikojmë qëndrimin me legjislacionin ndërkombëtar për sa u takon deklarimeve të shumave në kufi, ku ka pasur tërheqje veshi vazhdimisht për Shqipërinë, edhe për specifikën që ka Shqipëria, sepse ka një numër të madh qytetarësh shqiptarë, që punojnë

dhe jetojnë jashtë atdheut dhe, me prurjet që vijnë shpesh, përfiton edhe krimi i organizuar, duke sjellë fonde të caktuara. Tashmë, kemi hyrë në një fazë të re, ku përveç veprës penale, që ka qenë e parashikuar, i jepet mundësia agjencisë ligjzbatuese të procedojë administrativisht me gjoba, duke kategorizuar. Në fillim penaliteti është më i vogël, sepse mund të prezumojmë që vjen nga padija, pavarësisht se mosdijenja për ligjin nuk është shkak për ta përjashtuar dhe, për ta avancuar në mënyrë progresive, për rastet e përsëritura penaliteti të jetë më i lartë.

Zoti kryetar, mund të flasim gjatë për këtë ligj, por bëra një ekspozitë të përgjithshme për t'i dhënë mundësi gjithsecilit të njihet me këto dhe jemi të hapur për çdo propozim, për çdo përmirësim, për çdo pyetje që mund të kenë kolegët, por edhe kushdo tjetër, që është i interesuar të japë një dorë dhe një kontribut në këtë paketë të rëndësishme për legjislacionin shqiptar.

Dua t'ju ftoj që sot ta miratojmë në parim.

Të tria ligjet ruajnë një ekuilibër midis interesave madhorë për mbrojtjen nga pikëpamja financiare të ekonomisë në tërësi dhe të gjithë sistemit shoqëror, por, nga ana tjetër, ka mekanizma dhe ekuilibra për të ruajtur të drejtën e pronës ndaj kujtudo dhe për t'i dhënë mundësi kujtudo që në një kohë të menjëhershme, pa procedura të zgjatura, t'i rivendoset e drejta që mund t'i shkelet padrejtësisht, sepse kujtudo mund t'i kryhet një kufizim i pasurisë me të drejtë. Për arsye të ndryshme merren masa të menjëhershme, por, për sa kohë që kryhen verifikimet e nevojshme, mund të rezultojë që alarmi të ketë qenë jo i bazuar.

Prandaj, ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë në parim këtë paketë me 3 ligje dhe qoftë në adresën e komisionit, qoftë në adresën time personale apo qoftë në agjencitë ligjzbatuese në Ministrinë e Financave të nisin propozimet konkrete.

Zoti kryetar, besoj që në kalendarin e punimeve të Kuvendit të javës që vjen do ta kalojmë nen për nen për t'u mundësuar seancave të radhës, qoftë atyre të datave 13 apo 20 miratimin e këtyre 3 ligjeve për një arsye madhore që, para se të shkojmë në raportim në fund të qershorit, t'u themi *MONEYVAL-it* dhe partnerëve tanë që kemi bërë një reformë të konsiderueshme në legjislacionin e kësaj fushe.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Fino dhe më pas zonja Hysi!

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Ne ligjet i bëjmë për vete, nuk i bëjmë për të huajt dhe i forcojmë rregullat dhe për luftën ndaj terrorizmit apo të pastrimit të parasë për shtetin tonë.

Të nderuar kolegë, duke falënderuar relatorin për fjalët që tha, këtu kemi dy projektligje, që bëjnë dy ndryshime të ligjeve ekzistuese. Pra, ndryshime në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe propozimet e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”. Ndërkohë, kemi edhe një ligj të ri, që vjen sot si propozim: projektligji “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Duke falënderuar zëvendësministrin dhe stafin që bënë një ekspozitë të qartë apo edhe relatorin, kam një pyetje që më vjen drejtpërdrejt, sepse nuk kam pasur ndonjë lidhje me drejtoritë përkatëse, prandaj ndërhyra pak më parë. Në fakt, nuk e di që performanca e tyre të jetë kaq e lartë. Duhet të na e tregojnë me fakte konkrete nga se ka ardhur domosdoshmëria e ndryshimit të këtyre dy projektligjeve sot, duke përjashtuar ligjin e ri. Çfarë ka ndodhur në praktikë gjatë këtyre viteve, nga viti 2008 e deri më sot, gjatë të cilëve jemi ndaluar, jemi penguar që të bëjmë vërtet ndryshime rrënjësore, esenciale, sepse unë e kam lexuar pak shumë, për masat kundër financimit të terrorizmit apo edhe për projektligjin e pastrimit të parave?

Së dyti, shikoj një ashpërsim shumë të fortë të gjobave. Ne do të flasim edhe nen për nen, zoti Alket, dhe ju falënderoj edhe për thirrjen që na bëtë që, në qoftë se kemi vërejtje apo sugjerime, t’i bëjmë në adresën tënde elektronike apo edhe të përfaqësuesve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po edhe më vete mund të mblidhemi, por përsëri të gjithë bashkë do ta kalojmë.

Domethënë, ashpërsimi i gjobave është shumë i lartë dhe më lejoni t’ju them që diferenca midis dyshemesë dhe tavanit ka një disproporcion vërtet shumë të frikshëm. Nga eksperiencia që kemi nga shumë ligje që kemi kaluar, nuk kemi parë një disproporcion kaq të lartë. Për shembull, në nenin 26 “Te pastrimi i parave” thoni: “Subjekti gjobitet nga 100 mijë deri në 6 milionë, nga 200 mijë deri në 8 milionë, nga 300 mijë deri në 10 milionë, nga 1,5 deri në 10 milionë, nga 300 mijë deri në 20 milionë”. Ndoshta ashpërsimi i gjobave është i domosdoshëm dhe unë jam me dy duar që ta vendosim ashpërsimin e gjobave, por nuk kuptoj dhe dua të marr një përgjigje nga ju lidhur me këtë: nga praktika e përditshme e zbatimit të ligjit nga viti 2008 e deri më sot, ju keni hasur vështirësi në vjeljen e këtyre gjobave, apo kanë qenë më të vogla se sa i propozoni sot?

Së dyti, mund të na jepni ndonjë shembull nga legjislacionet e vendeve europiane, me të cilat preferojmë t’i përfaqësojmë ligjet tona nëse ekzistojnë këto lloj gjobash. Si janë legjislacionet e vendeve të tjera homologe, me të cilat duam t’i përfaqësojmë projektligjet përkatëse, sepse diferenca është shumë e frikshme, është shumë e madhe? Më lejoni t’ju them se kjo diferencë do të na bëjë të mundur që të mos ju paragjykojmë ju që punoni tani në këto

momente apo edhe të tjerët, të cilët do të vijnë pas jush. Në sensin që unë jam një nëpunës dhe një subjekti mund t'i vë një gjobë dysHEME, pra të vogël, por një subjekti tjetër, që nuk e kam shumë qejf mund t'i vë tavanin, këtë që keni vënë në ligj, të cilën e miratojmë ne.

Por që të jem i qartë dhe ta ngre dorën e ta votoj tamam dua të jemi sa më konkretë në vendosjen e gjobave, të cilat duhet të jenë në të mirë të punës, që edhe ju të ndiheni mirë për ato që do të vendosim.

Këto dy çështje kisha. Projektligjet janë shumë të domosdoshme dhe të nevojshme për t'i diskutuar. Kërkojnë pak kohë në diskutimin nen për nen, sepse ne jemi komision përgjegjës.

Ulsi Manja-Faleminderit!

Kolegia Hysi.

Vasilika Hysi-Faleminderit!

Zoti Koçi, më lejoni t'ju uroj për detyrën e re!

Gjithashtu, unë dua t'ju falënderoj si ekip për sjelljen e paketës së ndryshimeve në zbatim të rekomandimeve të Komitetit të Manivalit të Këshillit të Europës.

Kam pasur mundësinë të lexoj në mënyrë të detajuar planin e veprimit në pjesën teknike dhe të efektivitetit. Do të doja t'ju thosha që i është kërkuar Kuvendit që sekretari i Përgjithshëm të bëjë monitorimin e planit të veprimit si nga pjesa teknike dhe efektiviteti në kuadrin e kontrollit parlamentar, sikurse po bëhet për GRECO-n dhe mekanizmat e tjerë. Në këtë kuadër do të doja t'ju vija në dijeni që edhe me propozim të Kryetarit të Kuvendit do të ketë një angazhim të plotë të kontrollit parlamentar për zbatim një nga një të të gjitha rekomandimeve të Manivalit, nga Komisioni i Ligjeve, i Sigurisë, i Financave dhe të gjitha komisionet e tjera që ne i vlerësojmë, që janë të nevojshme të përfshihen për shkak të fushës së përgjegjësisë të tyre.

Unë kam disa pyetje dhe njëkohësisht për të shmangur diskutimin edhe një rekomandim për diskutimin nen për nen. Sikurse e tha edhe zoti Fino, kemi dy projektligje që ndryshojnë ligjet ekzistuese dhe një projektligj të ri që lidhet me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Kam lexuar me vëmendje relacionet tuaja dhe kam një pyetje për ju, zoti zëvendësministër, lidhur me projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit: Sa për qind e rekomandimeve të paraqitura në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të miratuara në dhjetor të vitit 2018 janë marrë në konsideratë në këtë projektligj? Kanë gjetur rregullim edhe rekomandimet për kompanitë e sigurimeve që janë disa.

A mendoni t'i rregulloni në ligjin e posaçëm, apo mendoni t'i adresoni nëse është e mundur në këtë ligj?

Ju në fjalën tuaj thatë se është zgjeruar numri i subjekteve, të cilat do të duhet të kenë një llogari bankare dhe të kryejnë të gjitha transaksionet bankare, keni futur të gjithë personat me TVSH, pavarësisht se janë persona fizikë dhe juridikë. Duke pasur parasysh që me ndryshimet e bëra në ligj subjektet me TVSH janë zgjeruar shumë, si e keni menduar ta adresoni zbatimin e këtij ligji që, në mendimin tim, është shumë i koklavitur dhe kërkon një informim, sensibilizim, edukim ligjor të të gjitha subjekteve privatë juridikë. organizatace ligjore e të tjera? Pra, a keni planifikuar që ndryshimet e këtij ligji mund të kuptohen e zbatohen drejt me hyrjen në fuqi të këtij ligji apo keni lënë ndonjë kohë të mjaftueshme për adresimin e rregullave ose instituteve të reja?

Së treti, vlerësoj faktin që ju keni përgatitur pasaportën indikatorëve për të dy projektligjet, por më bën përshtypje që te projektligji për parandalimin e financimit të pastrimit të parave dhe të terrorizmit analizoni vetëm ndikimet ekonomike dhe nuk gjej ndikime të tjera. Ky projektligj ka vetëm ndikim ekonomik? A nuk ka edhe ndikime të tjera sociale?

Pyetja tjetër është për shtojcën 2/a: pse nuk është bërë vlerësimi aktual neto i përfitimeve dhe vlera monetare në mënyrë të zbritshme për këto 10 vjet? Ka një tabelë që është bosh. A ka ndonjë vlerësim sa do të përfitohet nga zbatimi i këtij ligji? Ashtu siç tha edhe kolegu Fino, ne këto ligje nuk i bëjmë vetëm për të plotësuar kërkesat e Manivalit, por edhe për të parandaluar informalitetin, pastrimin e parave, përdorimin e parave të botës së krimit e kështu me radhë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me ligjin për agjencinë. Ne kemi bërë një reformë në drejtësi në vitin 2017 dhe pjesë e kësaj pakete ka qenë edhe përdorimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara për mbështetjen e fondit social, për mbështetjen ose për kompensimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Këtë ligj e kam lexuar me vëmendje, sepse më interesonte të dija nëse do t'i qëndrojmë atij rregulli që kemi parashikuar në vitin 2017, sipas të cilit paratë e konfiskuara, ose pasuria të luajtshme, ose e paluajtshme, pra një pjesë e tyre, me vendim të komisionit që funksionon, i kalon programit të parandalimit të kriminalitetit, është rregullim në Kodin e Procedurës Penale, i kalon kompensimit të vendimeve të kompensimit të viktimave, të cilat me vendim gjyqësor të formës së prerë duhet të marrin dëmshpërblim.

Ne kemi ratifikuar një konventë në vitin 2005, Konventën e Këshillit të Europës për kompensimin dhe dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunshme, konventën e Palermos dhe dy protokolle shtesë, të cilët e detyrojnë shtetin shqiptar që një pjesë e fondeve të pasurive

të konfiskuara dhe të sekuestruara t'i kalojnë mbështetjes së viktimave, pra fondit social, Ministrisë së Shëndetësisë.

Unë shikoj që në ligjin e ri të neni 25, ku flitet për destinimin dhe mënyrat e përdorimit të pasurive të konfiskuara, kjo kompetencë nuk i jepet komitetit shtetëror ku bëni pjesë ju zoti zëvendësministër, zëvendësministri i Brendshëm dhe një përfaqësues nga prokuroria, por i është lënë ministrit përgjegjës për Financat dhe nuk shikoj pikërisht këto elemente që këto para do të shkojnë, siç e thotë Kodi i Procedurës Penale, për të kompensuar viktimat e krimeve të dhunshme dhe krimit të organizuar. Cila është arsyeja që kjo nuk është parashikuar, sepse është kërkesë në disa konventa ku shteti shqiptar është palë.

Lexoj këtu të vlerësimi i ndikimeve, që është vënë theksi te ndikimi ekonomik, pra të ardhurat që do të krijohen. Po ndikimi social, po ndikimi në respektimin e të drejtave të palëve, po viktimat nuk është? Ne kemi harruar zemrën e reformës së drejtësisë penale. Njëra ka qenë lufta kundër korrupsionit, e dyta ka qenë forcimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të palëve në proces, ku fokus i veçantë janë viktimat, që është një kapitull më vete duke filluar nga neni 58 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Kur të vijë diskutimi nen për nen, unë ruaj të drejtën dhe do të komunikoj me kolegun Hyseni për të bërë rekomandime, amendamente, por do të doja për shumë nga kolegët që në komision nuk janë juristë, penalistë, të ketë një material për komisionin nen për nen, për shembull, neni 1 përmbush plotësisht, pjesërisht ose nuk merr në konsideratë rekomandimin 1 të Manival-it. Pra të ketë një tabelë ku të ketë një lidhje midis tabelës, planit të veprimit për pjesën teknike dhe nenit ku është reflektuar rekomandimi dhe pse është marrë plotësisht ose pse jo. Kjo është për të bërë kontrollin parlamentar ne, por edhe për të ndërhyrë nëpërmjet mekanizmit institucional, që drejton Kryetari i Kuvendit për të adresuar shqetësimet te Drejtoria e Doganave, KLSH, ILDKPI-ja, prokuroria.

Më vjen mirë që relator është zoti Hyseni, që ka përvojë në këtë fushë, dhe besoj se të gjithë bashkë do të bëjmë më të mirën, jo thjesht për të plotësuar Manivalin, por edhe për të plotësuar nevojat që ne kemi për të parandaluar pastrimin e parave dhe për të luftuar terrorizmin.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zonja Mara.

Aurora Mara- Unë kam vetëm një pyetje: në nenin 3, në fushën e zbatimit, në rastin e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në germën “c” është parashikuar masa e sekuestrimit preventiv, e cila nga Kodi i Procedurës Penale parashikohet si masë parandalimi, masë e përkohshme e marrë gjatë procedimit penal. Në fund të gjykimit gjykata

vendos sekuestron e pasurisë, ndërkohë që në Kodin e Procedurës Penale parashikohet edhe sekuestro konservative, që është masë për administrimin e pasurisë. Mos ndoshta është shumë e hapur gama e masës së sekuestrimit në rastin e sekuestrimit preventiv të pasurisë në një kohë që është një masë paraprake, nuk është një masë konfiskimi?

Faleminderit!

Ulsi Manja- A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina- Faleminderit!

Unë do të doja të dija, nga dijenia që ju keni nga vendimet e gjykatave, sa prej këtyre objekteve të sekuestruara u janë rikthyer pronarëve, pra si qëndron raporti? Unë mendoj se është e rëndësishme për faktin e administrimit, pasi parashikohet edhe shitja e këtyre pasurive edhe pa marrë ende vendimin e formës së prerë. Kjo mund të cenonte të drejtën e pronarëve të ligjshëm.

Ulsi Manja- A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Unë do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve, sepse këtu u bënë disa pyetje që duan edhe kohën e vet për t'iu përgjigjur.

Për shkak të një angazhimi të shkurtër timin, mendoj ta ndërpresim mbledhjen për ta vazhduar pas 20 minutash.

Zoti Shameti, sot jemi në votimin në parim dhe këto pyetje që u bënë, duhet të marrin përgjigje para votimit në parim, sepse nuk ka kuptim që të miratohen në parim këto projektligje dhe pastaj në mbledhjen e radhës të kishte përgjigje për pyetjet që u bënë sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e mbylлим dot deri në orën 14:00

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ju sugjeroni të vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve, unë ndërkohë kam ardhur. Jam shumë dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot do t'i kalojmë në parim.

Jam shumë dakord t'ia kaloj fjalën nënkryetarit.

Zoti Shameti, janë tri projektligje shumë të rëndësishme dhe sot vendosëm t'i kalojmë në parim që t'i japim kohën e duhur në dispozicion që në shqyrtimin nen për nen të kemi edhe mendimet e dy komisioneve të tjera, të Ekonomisë dhe Sigurisë. Kjo do të thotë që ne i kemi vlerësuar maksimalisht këto projektligje. Në dy prej tyre, në kuadrin e reformës në drejtësi ne kemi ndërhyrë në vitin 2016-2017, por sot vihet për të adresuar ndryshime të tjera.

Unë po ia kaloj drejtimin e mbledhjes zotit Lita. Sa të vij, do të vazhdojmë.

Korab Lita- Faleminderit!

Të ftuarit mund të vazhdojnë t'iu japin përgjigje pyetjeve.

Elton Haxhi - Unë do t'i përgjigjem pyetjes së zonjës Hysi në lidhje me llogaritë bankare të personave juridikë dhe fizikë, të cilët, mbase nuk u shpreha qartë, nuk janë pjesë e këtij ligji, janë pjesë e një ligji që do të vijë për procedurat tatimore. Pra, nuk e kemi në shqyrtim sot, megjithatë po ju bëj një sqarim. Arsyeja pse e bëjmë këtë ndërhyrje në ligj është për faktin e identifikimit të pronarit përfitues.

Pra, duke qenë se edhe nga raporti Manival pjesa e monitorimit të sistemit bankar ka rezultuar me përputhshmëri substanciale, ka qenë e vlerësuar shumë mirë, kemi menduar që nëpërmjet sistemit bankar, duke vënë një detyrimin për bizneset dhe gjatë procesit të hapjes së një llogarie bankare bëhet edhe deklarimi i pronarëve përfitues. Rrjedhimisht ne kemi një mundësi, që në çdo rast kur dyshohet për pastrim parash apo financim të terrorizmit, nëpërmjet sistemit bankar të kemi akses në identifikimin e pronarëve përfitues.

Për këto arsye është shtrirë edhe fusha e veprimit të ligjit të procedurave tatimore në lidhje me detyrimin për të pasur një llogari bankare, duke parë edhe pjesën e informalitetit që i është shtuar këtij aspekti, mendojmë që është një masë e duhur, për më tepër që kostot për hapjen e një llogarie bankare sa vijnë dhe ulen, pra sistemi bankar ka një shtrirje gjithmonë e më të gjerë në territor dhe nuk gjykojmë se është një kosto e tepruar qoftë edhe për ato biznese, të cilat janë në fashën mbi 2 milionë xhiro, që janë edhe subjekt i TVSH-së.

Sa u takon pyetjeve të tjera, në fillim do t'ua kaloj fjalën përfaqësuesve të Drejtorisë së Parandalimit të Parave për t'u përgjigjur për ligjet që ata kanë sjellë në komisionin tuaj dhe më pas administratorit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Fjala për ju.

Elvis Koçi – Faleminderit!

Pyetje e parë ishte nga zoti Fino: përse jemi duke i ndryshuar ligjet që kemi? Arsytet janë pikërisht gjetjet ose rekomandimet nga Manivali, por dy arsyet kryesore pse ne po i ndryshojmë janë, e para, koha e veprimit, sidomos për sanksionet ndërkombëtare, për të cilat transpozimi i tyre në legjislacionin tonë të brendshëm kërkon kohë, ndërkohë që pjesa e sanksioneve që i përkasin terrorizmit duhet që, sipas legjislacionit ndërkombëtar, të jetë pothuajse e menjëhershme. Me fjalën “e menjëhershme”, nënkuptohet në rang orësh dhe për ta bërë të mundur këtë ata duhet të ndërhyjnë në ligji.

Arsyeja tjetër pse ne po ndërhyjmë është te pjesa e keshit në kufi. Aktualisht për keshin në kufi, dënimi është kur ajo gjendet që është pjesë e një veprë penale dhe nuk ka fare masë

administrative dhe shpesh ky deklarin anashkalohet me mendimin që nuk po kryhet vepër penale dhe realisht ndodh kështu. Ne duam që të mos anashkalohet në asnjë rast dhe, duke pasur masën administrative që është gjobë, të mund të sigurojmë deklarime të rregullta në kufi.

Gjithashtu, aty preken edhe rekomandime të tjera, të cilat do t'i shohim në veçanti nën për nen kur t'i diskutojmë, por ju i keni në relacion.

Sa i përket pjesës së ndikimeve të tjera dhe ndikimit ekonomik, për këtë pjesë do të përgjigjet kolegu Muslia. Sa u takon të ardhurave nga ky projektligj...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po ta shihni pikën, aty parashikohen pesë masa që mund të merren dhe vetëm njëra prej tyre është gjobë. Synimi ynë nuk është aplikimi i gjobave, por atje ku është e nevojshme për t'i kthyer në ligjshmëri subjektet do të na duhen t'i aplikojmë gjobat, por shpeshherë ka subjekte të vogla, siç mund të jetë një biznes i vogël që ka detyrimin e TVSH-së, ndërkohë që ka edhe biznese shumë të mëdha, ku bëhen transaksione në miliona euro dhe detyrimisht edhe gjoba është e ndryshme. Sigurisht, nga ana procedurale të gjitha këto do të parashikohen në procedurat e brendshme në proporcionalitet, me përqindje përkatëse ndaj shkeljes që vihet re dhe patjetër që do të jetë pjesë e paketës që do të shoqërojë edhe zbatimin praktik të tyre se si do të vendoset gjoba.

Sa i takon pjesës së përfitimeve, të cilën e ngriti zonja Hysi, synojmë të mos kemi përfitime, sepse ne nuk e shohim aplikimin e gjobës si një të ardhur për buxhetin e shtetit. Më e mira do të ishte të mos e aplikojmë asnjëherë gjobën, por të gjithë të deklaronin, prandaj nuk e kemi parashikuar dhe nuk kemi ndonjë mënyrë që ta parashikojmë, sepse ato që nuk deklarohen sot, ne nuk duhet të presim që prapë ato të mos deklarohen vitin tjetër dhe të marrin gjoba, por ne presim që ata të kthehen në normalitet dhe të deklarohen.

Korab Lita – Zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën.

(Diskutime pa mikrofon)

Do të mbarojmë një herë me përgjigjet? Në rregull!

Po, zoti Muslia.

Agim Muslia - Faleminderit, zoti nënkryetar!

Më lejoni fillimisht t'ju falënderoj për mbështetjen që ky komision dhe anëtarët e nderuar kanë dhënë në vijimësi për zhvillimet ligjore të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave!

Pa humbur kohë po mundohem t'ju jap përgjigje ndoshta jo shteruese, por aq sa të na lejojë momenti dhe në një moment të dytë do t'ju jap një informacion më të detajuar.

Sa i takon pyetjes për përqindjen e rekomandimeve që adresohen nëpërmjet këtyre dy projektligjeve, të projektligjit për masat kundër financimit të terrorizmit dhe të projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kjo është një pyetje me vend dhe ne mendojmë se i kemi adresuar këto rekomandime që kanë qenë problematike. Më konkretisht, për ligjin nr. 157 është vetëm një rekomandim, rekomandimi 6, për sanksionet ndërkombëtare, dhe ne e kemi evidentuar këtë në relacion, si dhe jemi të gatshëm të bëjmë një tabelë më të detajuar për të bërë një korrelacion më të drejtë jo vetëm me rekomandimet, por edhe me kriteret esenciale, sipas metodologjisë.

Sa i takon ligjit për parandalimin e pastrimit të parave janë një sërë rekomandimesh për të cilat kemi synuar që të jenë në përputhshmëri të plotë, këtu bëhet fjalë për rekomandimet 1, 6, 10, 12, 16, 17 dhe 24. Sigurisht, siç edhe jua përmenda, do të bëjmë një tabelë më të detajuar, të cilën do t'jua paraqesim më vonë.

Ne mendojmë, të paktën ky është opinionin ynë, që në vlerësimin e radhës, gjithmonë bëhet fjalë për pjesën teknike të vlerësimit që ne do të raportojmë së shpejti, këto projektligje të kenë trajtuar në mënyrë shteruese mangësitë që kanë dalë nga raporti i fundit i Komitetit Manival.

Sa i përket vlerësimit të ndikimit në ekonomi, kjo është një pyetje me vend, por në të njëjtën kohë është një pyetje tejet komplekse. Pse jua them këtë? Jua them këtë, sepse prej vitesh kam marrë pjesë në Komitetin Manival si përfaqësues i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe një nga pyetjet që shtrohet në vijimësi është: cila është kostoja e krimit ekonomik me të cilën përballen vendet? Ka metodologji nga më të ndryshmet, fatkeqësisht më duhet ta pranoj që ne jemi ende në fazat e para të përllogaritjeve të kësaj natyre, por lajmi pozitiv është që ne kemi bërë një vlerësim kombëtar të riskut në vitin 2012, kemi bërë një rishikim në vitin 2015 dhe aktualisht jemi duke bërë një rishikim të dytë. Në këtë vlerësim kombëtar të riskut, ndonëse është cilësor dhe jo sasior, ka edhe elemente sasiore, siç janë lloji i veprave që gjenerojnë të ardhura, kategorizimi i tyre, aty ku është e mundur të ardhurat që janë gjeneruar, të cilat më pas i janë nënshtruar procesit të sekuestrimit dhe konfiskimit për ato raste që kemi të dhëna, dimensionin e bashkëpunimit ndërkombëtar, për të parë se cili është efekti i veprave penale që kryhen jashtë Republikës së Shqipërisë dhe më pas të ardhurat e jashtëligjshme që i nënshtrohen procesit të pastrimit në vendin tonë.

Me një fjalë është një proces tejet kompleks dhe nuk mund t'ju siguroj që mund të kemi një raport të detajuar, por ky vlerësim kombëtar risku do t'i japë përgjigje disa prej pyetjeve.

Pyetja tjetër kishte të bënte me përfitimin nga zbatimi i ligjit. Kjo pyetje është me vend, por edhe për këtë pyetje nuk mund të krijojmë një ide të qartë apo të kemi një shifër të saktë, por duke qenë se ju, zonja Hysi, jeni prej kohësh pjesë e këtij komisioni të nderuar, e mbani mend periudhën në të cilën Shqipëria ishte pjesë e një monitorimi më të zgjeruar nga FATF, që është grupi i posaçëm i veprimit financiar dhe si pasojë e të cilit Shqipëria ishte subjekt i monitorimit të përforcuar për tre vjet radhazi.

Edhe vende më të fuqishme se ne, që kanë qenë në këtë proces, nuk kanë qenë në gjendje të thonë sa investime të huaja janë ndaluar. Cila ka qenë kostoja e transaksioneve ndërkufitare? Cila ka qenë kostoja e kryerjes së biznesit shqiptar në botë ose kostoja e hapjes së llogarive bankare në vende të ndryshme? Pra, ka një sërë parametrash që, po t'i marrësh në tonalitetin e tyre, kanë efektin e tyre, por në terma sasiorë ne nuk mund ta themi se cili është, por pa dyshim që kjo ka një efekt.

(Diskutime pa mikrofon)

Korab Lita - A mbaruam me përgjigjet e pyetjeve? Jo.

Të mbarojmë një herë me përgjigjet e pyetjeve dhe më pas do të vazhdojmë me diskutimet e tjera.

Po, zoti Kala.

Artur Kala – Unë quhem Artur Kala dhe jam drejtor i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ju falënderoj për mundësinë që na keni dhënë për të prezantuar një ligj të ri të Agjencisë së Administrimit të Pasurive, një ligj që do të shërbejë qoftë si ligji organik i agjencisë, por edhe si ligj për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Nëpërmjet këtij ligji ne synojmë ngritjen në një nivel më të lartë të të gjithë procesit aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek agjencia. Sa për informacion, agjencia funksionon prej 11 vjetësh dhe besojmë se ka fituar një eksperiencë shumë të mirë gjatë këtyre viteve. Në administrim kjo agjenci ka pasur pasuri që rrjedhin nga ligji antimafia dhe financim të terrorizmit, por ajo që synojmë nëpërmjet këtij ligji është fakti që të marrim edhe pasuri të tjera, që rrjedhin nga Kodi Penal, siç është edhe rekomandimi, zgjerimi i kompetencës së agjencisë.

Tani po dal te pyetja e deputetes Hysi, pasi ne kemi pasur një bashkëpunim të gjatë me të edhe gjatë kohës që ka qenë kryetare e Komisionit të Ligjeve, duke na mbështetur dhe e falënderoj për këtë!

Zonja Hysi ka qenë pjesë e inaugurimeve tona për çështje sociale dhe e di që e ka shumë merak këtë pjesë, por prioriteti ynë si agjenci ka qenë gjithmonë përdorimi social, kalimi i pasurisë të komunitetave ku është marrë kjo pasuri dhe aq më shumë të viktimave të krimit dhe të trafikimit.

Në ndryshimet që i janë bërë ligjit antimafia të vitit 2015, kemi futur kompensimin e viktimave të trafikimit dhe asgjë nuk ka ndryshuar në vendimarrje. Këtu i referohemi nenit 24, në të cilin thuhet se do të jetë Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve ai që do të mbikëqyrë administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara sipas fushës së veprimit për masat kundër krimit të organizuar. Ky komitet përbëhet nga 8 anëtarë dhe është përfaqësues i prokurorit të Përgjithshëm, i gjyqësorit, i ministrit të Brendshëm, i ministrit të Financave, i cili është edhe kryetar i komitetit, si dhe zoti Haxhi, si dhe i ministrit të Mirëqenies Sociale apo i ministrit të Shëndetësisë, që mbulon problemet sociale.

Sa për informacion, ne kemi miratuar tri fonde të posaçme gjatë këtyre viteve të fundit dhe fondi i tanishëm, i firmosur nga ministrja me rekomandim të Komitetit, është 97 milionë lekë, ku 80% e këtij fondi do të përdoret për përdorim dhe mbështetje sociale të OJF-ve, qendrave dhe programeve sociale të ndryshme.

Gjithashtu, sa u takon pasurive, siç e thashë edhe më lart, objektivi i agjencisë ka qenë gjithmonë kalimi në përdorim dhe ne kemi kaluar, siç dihet, laguna, pasuri në toka shkollave, pushtetit lokal, policisë, prokurorisë, Qendrës Kombëtare të Viktimave të Trafikimit, e cila sot është ndër qendrat më të mira falë edhe mbështetjes së agjencisë, e cila më parë vlerësohej si një qendër në pamundësi për të pritur viktimat, ndërsa sot është një prej qendrave më të mira në Ballkan.

Gjithashtu, ju iu referuat nenit 25, i cili flet për ministrin përgjegjës të Financave, por kjo kështu ka qenë dhe ne nuk kemi ndryshuar asnjë gjë nga ligji antimafia, por me rekomandim të Komitetit Këshillimor për nxjerrjen e urdhrit të konfiskimit të pasurisë ministri bazohet në rekomandimin e komitetit këshillimor të ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar, në raportin e agjencisë dhe në kriteret e përcaktuara në pikën 2, respektimi për dhënien në përdorim të pasurive e të tjera.

Unë besoj se jemi po në atë frymë të ligjit antimafia, por thjesht e kemi ngritur në një nivel pak më të lartë, aq më tepër që do të dalin edhe VKM në mbështetje të kësaj.

Sa i takon VNM-së, ke shumë të drejtë, ndoshta duhet të ishte parë me një sy tjetër, por ne nuk e dinim këtë gjë dhe ajo u bë në mënyrë pak të shpejtë.

Sa i takon pyetjes për raportin, në fakt, raporti ka shqetësuar edhe agjencinë me sekuestrimet dhe konfiskimet, pra nuk është ndonjë raport që mund të krahasohet me vendet e

tjera të Europës dhe të Ballkanit, sepse normalisht numri i konfiskimeve është shumë i vogël dhe trendi i sekuestrimeve vitet e fundit ka qenë në rritje, ndërsa konfiskimet në rënie shkojnë te 65-70 % e pasurive, revokohen. Pra, është një problem prej agjencisë.

Së bashku me Ministrinë e Brendshme i kemi nisur një shkresë KLP-së dhe KLGJ-së me një informacion të detajuar të analizës konkrete të viteve të fundit. Pas përfundimit të reformës besoj se do të kemi edhe një raport tjetër më të plotë që nuk dëmton agjencinë.

Për Kodin Penal ne i jemi referuar pjesës preventive, sepse aty janë 3 sekuestro, gjithsesi, kur ta diskutojmë nen për nen (kjo ha diskutim), mendojmë se këto janë pasuri që mund t'i administrojë agjencia.

Ju falënderoj!

Korab Lita - Nëse keni mbaruar me përgjigjet, fjalën e ka relatori.

Alket Hyseni – Faleminderit!

Do të përpiqem t'i jap përgjigje ndonjë aspekti që nuk i është dhënë plotësisht, por edhe në karakterin politik të përgjigjes.

Do ta filloj nga arsyeja pse vijmë me këtë paketë. Çështja nuk është pse vetëm ai kërkoi Manivalin, patjetër që shkaku kohor për t'i kaluar shpejt këto projektligje është Manivali dhe raportimi që do të bëjmë atje. Duhet të kuptojmë që nuk jemi më shtet sovran dhe do të thotë që ne nuk kemi detyrime ndaj partnerëve dhe organizmave ku aderojmë.

Qenia anëtar dhe nënshkrimi i disa akteve ndërkombëtare sjell edhe detyrime për përmirësimin e legjislacionit. Duhet të dini që këto janë më shumë teknike në dukje, por janë edhe politike në thelb. Ne e sollëm këtë paketë, sepse mendohet që është domosdoshmëri për vendin, në radhë të parë, por edhe kërkesë e partnerëve tanë dhe e Manivalit në mënyrë të veçantë, nga ana tjetër.

Janë ligje jo thjesht për aspekte ekonomike, mirëfilltazi ato kanë impakt të drejtpërdrejtë ekonomik në përcaktimin dhe ruajtjen e ekuilibrave dhe rregullave të lojës për mosprishjen e parimit të konkurrencës së ndershme, por janë politike, sepse luftojnë hapur korrupsionin dhe janë në fokusin e gjithë paketës së madhe të reformës sonë në drejtësi.

Ju do të shikoni që keni pjesë në ligj (kur ta diskutojmë nen për nen, do të azhurnoheni edhe më tepër), që kanë lidhje me personat e ekspozuar politikisht, me saktësimin e procedurave lidhur me këta persona.

Shpesh, nëpërmjet anëtarësimit (zoti Shameti, se je edhe biznesmen, dhe duhet të dëgjosh) në persona juridikë apo në shoqata të ndryshme, nuk specifikohet prania e personave juridikë, apo çështje që kanë të bëjnë me zotin Shameti dhe zotin Çyrbja dhe çështje që kanë të bëjnë, për shembull, me aspekte të veçanta me sigurimin e jetës, të cilat deri sot nuk kanë

qenë të involvuara nga ky ligj. Këto janë aspekte politike, në radhë të parë, janë aspekte shtetformuese, në radhë të dytë, dhe patjetër, janë ekonomike, në radhë të tretë.

Dua t'u përgjigjem disa pyetjeve të veçanta, pyetjes së kolegut Fino, që unë e falënderoj, ai nuk është nga ata që bën pyetje sa për të thënë. Ai bëri një pyetje lidhur me penalitetet dhe tha: "Amplituda e penaliteteteve më duket e madhe, kalimi nga 100 mijë në 600 mijë". Dua ta sqaroj se, së pari, po në të njëjtin nen, pika më para se të dilnin te penalitetet sqaron kriteret se si përcaktohen penalitetet. Po të shikoni, në mos gaboj, neni 26 thotë: "Për përcaktimin e masës dhe llojit të sanksioneve merren parasysh fuqia financiare e personit juridik përgjegjës për shkeljen", do të rregullojmë disa terma jo vetëm juridikë: përfitimi që mund të ketë pasur subjekti nga kjo shkelje; humbjet që mund të jenë shkaktuar ndaj palëve të treta nga kjo shkelje; niveli i bashkëpunimit të subjektit me autoritetet kompetente; shkalla e përgjegjësisë së subjektit që ka kryer shkeljen, kemi parimet e përgjithshme që janë: "rrezikshmëria shoqërore e shkeljes", që janë te Kodi i Procedurës Administrative, pasi agjencia funksionon edhe mbi bazën e këtij Kodi dhe ka një procedurë strikte. Ndryshe është grupi që bën kontrollin dhe ndryshe është organizmi që merr vendimin dhe i propozon drejtorit vendimmarrjen dhe kjo është bërë me këtë qëllim, që të mos abuzohet. Janë në tërësinë e ligjit, se këtu janë vetëm ndryshimet. Pastaj, detajohen disa procedura edhe me vendim të Këshillit të Ministrave, edhe me udhëzim të ministrit të Financave që saktësojnë këto elemente. Ka një komision për shqyrtimin e shkeljes administrative, i cili nuk ndikohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, këta janë mekanizmat që i japin mundësi agjencisë, që për një person që e ka shkeljen për herë të parë, dhe një person që është dukshëm i panjohur me procedurat, merr minimumin.

Cilat janë rezultatet që kanë sjellë këto agjenci? Unë po flas për njërin, por drejtori sapo përmendi tjetrën. Në të gjitha vitet e ekzistencës së Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, deri në vitin 2013 ishin sekuestruar vetëm 8 milionë dollarë llogari bankare dhe asete. Vetëm në vitet 2014-2016 janë sekuestruar 7 herë më tepër. Në vitin 2016 janë sekuestruar gati 30 milionë dollarë llogari bankare dhe asete. Kjo tregon që agjencitë tona ligjzbatuese, sidomos në vitet e fundit, kanë gjetur rolin që u jep ligji dhe ne duam t'u japim akoma më tepër mundësi me këtë ligj, që ato të jenë efikase. Aty ku kemi çaluar, është ajo që përmendi drejtori, që gjithë ky volum pune që mund të mos ishte edhe më shumë, nuk konvergjon në fund te kalimi i këtyre pasurive në të mirë të shoqërisë, sepse këto vidhen nga shoqëria dhe ne duam t'i parandalojmë këto akte, por ato sekuestrohen dhe konfiskohen të vijnë

përsëri në shoqëri me vlerën e tyre reale maksimale. Kjo gjë nuk është kryer në të gjitha rastet, sepse edhe legjislacioni ka pasur mangësi.

Ne jemi përpjekur që këtë gjë ta bëjmë sot.

Për të ardhur te shqetësimi i koleges Hysi se ku do të shkojnë këto të ardhura, po t'i referohesh neneve 27 dhe 25, që ju vet iu referuat, thuhet: “Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të detajuara qoftë për mënyrën e administrimit, por qoftë edhe destinimin përfundimtar të këtyre pasurive”. Si bëhet? Destinimi bëhet në bazë të tërësisë së legjislacionit, jo vetëm të këtij ligji, jo vetëm të ligjit antimafia. Këto janë dy mekanizma, por gjithë legjislacioni shqiptar dhe gjithë ajo paketë do të shkojë patjetër edhe për viktimat e trafikimit, edhe për të miturit, ashtu siç ne e kemi parashikuar.

Mënyra e detajuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjove si thashë në fillim?

Do të jap një shembull, zoti Fino: unë ju thashë që këto treten rrugës, vetëm kockat ngelen, prandaj po i bëjmë këto ndryshime, që kur të vijmë pas dy vjetësh, ne dhe agjencitë atje, të mos kemi më gojë të themi “shiko se çalonte ligji këtu apo atje”. Tani ligji nuk është perfekt, por nuk çalon të paktën.

Madje, për këto statistika që ju thashë se duhet të jemi krenarë, se mbas disa viteve do të themi se u sollën të gjitha në buxhetin e shtetit dhe nuk mbetën rrugës. Gjykatat e korruptuara ua kthejnë prapë personave, dënohet personi për veprën, por i rikthehet pasuria, që është *non sens*. Por këtë e korrigjon edhe reforma në drejtësi, jo vetëm kjo paketë. Nuk janë të shkëputura nga njëra-tjetra.

Prandaj edhe shqetësimi i zonjës Mara, që është zgjeruar te sekuestrot preventive, sepse çfarë ndodh, merret një pasuri sot dhe deri sa të vijë konfiskimi pas 5 vjetësh, pasuria...

Vetingu ka një konsum, ai amortizohet ose i bie vlëra dhe ndodh që në fund të procesit, nuk ka më interes as shteti. Ai thjesht ka kostot që ta mbajë atë dhe ne tani u japim mundësi administratorëve që të marrin vendime për pasuri të caktuara, t'i shesin menjëherë, të mbajnë llogari, nëse del i pafajshëm i kthehet subjektit, por nëse del fajtor, kalon në buxhetin e shtetit. Është ruajtur ekuilibri i parimeve kushtetuese.

Pyetje mund të ketë pafund, sepse dispozitat janë teknike, por në diskutimin nën për nen, secili do të ketë mundësi... duke u referuar edhe në material, në fund të relacionit, keni referimet në kritere. Kriteret janë ato strikte, teknike. Shikojeni relacionin në faqen 5, pikat 7, 8 deri në 11 tregojnë se cilat kritere përmbushin rekomandimet dhe aktet e detyrueshme për zbatim nga agjencitë tona.

Megjithatë, këshilltarët janë aty dhe po mbajnë shënim. Në shpjegimet që do të kemi, duhet të kemi edhe një formë tabele të detajuar me referimin se cili rekomandim përmbushet dhe, mundësisht, edhe me kriteret përkatëse duke bashkëpunuar me të dyja agjencitë.

Ju faleminderit!

Korab Lita – Faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit për përgjigjet!

Duke pasur parasysh përgjigjen që dha zoti zëvendësministër, që një pjesë e rekomandimeve janë adresuar këtu, një pjesë janë në ligjet e tjera, meqenëse brenda muajit qershor duhen miratuar dhe ne do të raportojmë në fund, lidhur me ligjin për procedurat tatimore që ju përmendët, lidhur me ligjin për qendrën e regjistrimit të biznesit, lidhur me ligjin për OJF-të, të cilat, sipas planit të veprimit duhet të miratoheshin brenda muajit janar 2019, brenda muajit mars e të tjerë, kur do të vijnë në Kuvendin e Shqipërisë? E para.

E dyta, në planin e veprimit, po bëj një parantezë, i bëra gjithë këto pyetje, se po të kishim edhe paketën e akteve nënligjore paralel, pavarësisht se nuk i miraton Kuvendi, ne kemi kërkuar që këto projektligje të vijnë bashkë me paketën e akteve nënligjore. Është një vendim që e ka marrë Komisioni Ndërinstitucional për Ndjekjen e Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese, ose të krijuara me ligj. Ne gjithmonë kemi kërkuar nga qeveria që, kur ka reforma kaq të rëndësishme, të thella, sensitive, me sensibilitet brenda dhe jashtë vendit, të paktën edhe aktet (projektet) nënligjore të nevojshme, të jenë për të parë nëse fryma e ligjit dhe ndryshimet përputhen ose rregullohen në mënyrë të detajuar me akte, apo lihen përsëri evazive dhe rekomandimet që bëjnë qoftë institucionet vendase dhe ndërkombëtare nuk zbatohen. Këto ishin sipas planit të veprimit për të hyrë në fuqi brenda muajit mars 2019 të gjitha rastet, ose në vitin 2018.

Keni ndonjë tabelë apo kalendar të ardhjes së pjesës tjetër të projektligjeve dhe të akteve nënligjore? Ndryshe vlerësimi nga Manivali do të jetë jo ai që do të dëshironim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Haxhi, fjala për ju.

Elton Haxhi – Ndryshimet në ligjin për QKB-në dhe në ligjin për procedurat tatimore janë duke u diskutuar nëpër komisione. Sot në mëngjes ka pasur një seancë me Komisionin e Ekonomisë në lidhje me këto dy ligje.

Ndërsa lidhur me OJF-të, nuk është identifikuar ndonjë ndryshim ligjor, përveçse ndryshimit në një udhëzim të ministrit të Financave, që ka lidhje me procesin e monitorimit që bën Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për OJF-të.

Ne jemi duke punuar për aktet nënligjore, të cilat nuk janë përfunduar ende. Pavarësisht se ligjet nuk janë miratuar, është filluar puna për të pasur edhe aktet nënligjore brenda qershorit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhi!

Unë nuk e thashë në fillim, në fakt, paketa ka 5 projektligje. 2 nga këto projektligje janë për diskutim në Komisionin e Ekonomisë, si komision përgjegjës, 3 janë këto që kemi ne sot, janë pjesë e paketës së 5 projektligjeve, por ne jemi komision përgjegjës vetëm për këto 3 projektligje.

Ka mbetur pyetje pa përgjigje? Jo.

Atëherë, i hedhim në votim në parim një nga një.

Vazhdojmë me projektligjin e parë “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji i dytë “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji i fundit i paketës “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, projektligj i ri.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Me miratimin në parim të këtyre projektligjeve, e mbyllim për sot mbledhjen e dytë të komisionit, ndërsa shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të të tri projektligjeve do ta bëjmë në mbledhjet e ardhshme, pasi të na kenë ardhur raportet e dy komisioneve të tjera.

Faleminderit për durimin, por edhe për përfshirjen në debat dhe diskutim!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA